

JETA SHKENCORE

**KONFERENCA SHKENCORE “STUDIMET LETRARE NË PROCES:
REZULTATE DHE PROBLEME”, III,
Tiranë, 14 korrik 2017**

Departamenti i Studimeve letrare i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, organizoi më datë 14 korrik 2017, konferencën shkencore: “Studimet letrare në proces: rezultate dhe probleme”, III, me pjesëmarrje të anëtarëve të Departamentit dhe të studentëve të shkollave doktorale.

Fjala e hapjes u mbajt nga përgjegjësjë e Departamentit të Studimeve Letrare, prof. dr. Laura Smaqi, e cila foli ndër të tjera mbi veçantinë e kësaj konference, ndonëse e treta në radhën e konferencave të zhvilluara me të njëjtën temë kryesore orientuese.

Konceptuar në formën e një tryeze të rrumbullakët, ku numri më i kufizuar i pjesëmarrësve, orientonte vëmendjen kryesore drejt diskutimeve, konferenca nisi me kumtesën e prof. as. dr. Evalda Pacit, *Dëshmi shkrimore e historike të një periudhe të rëndësishme për letërsinë e shkruar shqipe (Koncili i Arbënit:1703)*. Më pas doktorantja Blerina Harizaj foli mbi *Elemente të intertekstualitetit në poezinë “Fyelli” të Naim Frashërit*, prof. asoc. dr. Eriona

Tartari vijoi me *Teza, hipoteza: Rilindja Kombëtare midis Iluminizmit dhe Romatizmit*. Doktorantja Kozeta Kita, me temën *Leximi si rilexim*, u përqendrua në romanin “Karpa” të M. Camajt. Prof. asoc. dr. Merita Bruci, mbajti kumtesën *Nemo propheta in patria: rasti Santori*, doktoranti Hekuran Hasanaj paraqiti një *Sprovë për rindërtimin prapavajtës të kriterëve të zbatuara në veprën “Anthologji shqipe e kësikohëshme”, 1937, të Llazar Gushos*. Romanet – ditar të viteve ’30-’40, ishin në qendër të kumtesës së prof. dr. Laura Smaqit. Doktorantja Luljeta Bora-Bejleri, kumtoi mbi *Polisemantikën e shprehjes së figurshme të Arapit në krijimtarinë e tij poetike të viteve ’80*. Dr. Rovenë Vata, vijoi me *Doket, ritet e kultet shqiptare në romanin “Karpa” të Martin Camajt*, Doktorantja Adriana Duka foli mbi *Personazhin shëtitës në tregimet e Kim Mehmetit*, ndërsa dr. Virion Graçi, kumtoi mbi *Procedime artistike për karakterizimin e personazheve në romanin “Epika e yjeve të mëngjesit” të Rudi Erebarës*.

Diskutimet e zhvilluara ishin mjaft interesante. Ato thelluan akoma më tej idetë e shprehura në kumtesat e paraqitura dhe nxitën

qasje të mëtejshme, më të thelluara, të cilat do të jenë objekt i konferencave vijuese.

Laura Smaqi